

AKT THEMELIMI I WEBSOFT

Sot me datë 11/04/2022, unë i nënshkruari: Znj. Xhesika GIPSI

E bija e Kujtim dhe Shirete, e dtl. 01.03.2002, lindur në Lushnje dhe banuëse në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shpreh vullnetin tim të lirë për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë WEBSOFT SH.P.K si me poshtë vijon:

1. FORMA LIGJORE “SHPK”, éshtë një Shoqeri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar.

2. ORTAK I VETEM THEMELUES

Ortak vetëm, themelues i shoqërisë éshtë **Znj. XHESIKA GIPSI**

3. OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë të shoqërisë **WEBSOFT SHPK** éshtë :

Programim dhe design te Fafeve te Internetit; Projektim, prodhim dhe shitje te sistemeve kompjuterike dhe software drejt bizneseve dhe konsumatorëve brenda dhe jashtë vendit ; Realizim sistemesh ERP, CRM, HR, etj; Zhvillime Aplikacionesh Mobile (Android & Ios) ; Sherbime dhe Konsulencë Informatike në biznese dhe individë; Trajnine ne fushat e Teknologjise se Informacionit; Perfaqesi te kompanive te huaja, per produktet apo sherbimet te cilat lidhen direkt apo indirekt me Shoqerine; Konsulencë ne fushen e marketingut; Realizim identiteti per biznese dhe individë; Realizim fushatash publicitare, Promovime dhe Marketing nepermjet Email, Facebook, Google,SMS; Zhvillim dhe pozicionim i faqeve te internetit ne motorret e kerkimit (SEO). Aktivitetet e analizes, projektimin, zhvillimin, dokumentimin, instalimin e sistemeve kompjuterike, te teknologjise kompjuterike dhe rrjeteve dhe kryerjen e sherbimeve te lidhura; Prodhim dhe Shitje software, dizenjim dhe zhvillim, projektim i detajuar i software dhe database, analize, zhvillim, programim dhe integrime ne sisteme te ndryshme. Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjeter të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë dhe qe nuk bie ndesh me legjislacionin Shqiptar ne fuqi;

4. SELIA

Selia e shoqërisë tregtare **WEBSOFT SHPK** do të jetë në adresën: Rruga Arkitekt Sinani, prane Xhamllikut, Tirane

5. KOHEZGJATJA

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë kohore të pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar. Afati i përmendor në pikën 1 të këtij nenit mund të shkurtohet apo zgjatet me vendim të Ortakut të vetëm të shoqërisë, në përputhje me rregullat e percaktuara nga Statuti i Shoqërisë.

6. KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqerisë tregtare **WEBSOFT SHPK** është 100,000 (njeqindmije) Leke. Kapital thermeltar është i ndarë në 1 kuotë dhe vlera nominale e një kuote është 100,000 (njeqindmije) lekë.

Ortaku i vetëm është zotëruesi i të gjitha kuotave të shoqërisë, në vlerën 100% të tyre. Kuotat janë nominative dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë. Cdo kuotë përfaqëson të drejtën e një vote.

7. ORTAKU I VETEM

Ortaku i Vetëm ushtron kompetencat që ligji i jep Asamblesë së Ortakëve.

8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqeria drejtohet nga Administratori.

Administrator i parë i shoqerisë **WEBSOFT SHPK** është **Znj. XHESIKA GIPSI**

9. SHPERBERJA DHE LIKUIDIMI

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarë do shkaku ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjeter që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërise.

Themeluesi

ZNJ. XHESIKA GIPSI

Xhesika Gipsi
